

Ceremonia e diplomimit të pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve 2022

NË KËTË EDICION

AKTIVITETET E

Ceremonia e diplomimit të pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve 2022

NRC-SË

Mbi Vullnetarizimin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri

Aktivitetet nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Forumi i OJF-ve "Përgjegjshmëria e OJF-ve në Bashkëpunimin për Zhvillim Efektiv"

Akademia e OJF-ve

Programe Trajnimi për OSHC-të

ZHVILLIMET E

FUNDIT NË SEKTOR

Komisioni Evropian ka publikuar Paketën e Zgjerimit 2022

Mbledhja e Keshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile – KKShC

Konferenca Kombëtare e Vullnetarizimit 2.0 - "Infrastruktura e Vullnetarizimit në Shqipëri, Sinergjitë dhe Sfidat"

Java e Integritetit në Shqipëri

Java e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri #JavaOKB2022

Dita Kombëtare e Aktivizimit #NAD2022

LevizAlbania - Prezantimi i Platformës së Njohurive për Angazhimin Qytetar

Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2021

Forumi i shoqërisë civile & Think Tank 2022

Analiza vjetore nga BCSDN: Shoqëria Civile në Ballkanin Perëndimor në realitetin e ri gjeopolitik


THIRRJE DHE

MUNDËSI

Thirrje

Njoftime

Njihuni me publikimet tona më të fundit



Dëftesat mbi Progresin dhe Nivelin e Përgatitjes së Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE merr si pikënisje gjendjen e përshkruar në Raportin e KE 2021 dhe pasqyron zhvillimin gjatë një viti, kristalizuar në Raportin e KE 2022. Ajo synon të shfaqë në një gjuhë më të lexueshme 1) Kriterin politik; 2) Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 3) Kapitullin 24 (Drejtësia, Liria, Siguria).



Më 22 dhjetor 2022, Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore organizuan ceremoninë e diplomimit të pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve 2022. Akademistët u mbledhën, tashmë si Alumni në të kurorëzuar një vit përpjekje dhe investim në rritjen e njohurive të tyre individuale si dhe konsolidimin organizativ të mëtejshëm të organizatave të tyre.

Gjatë programit të Akademisë të këtij viti, 23 drejtues dhe menaxhere programesh të OJF-ve të reja por edhe të konsoliduara ndoqën një seri leksionesh, seancash mentorimi dhe vizita studimore duke shkëmbyer njohuri dhe eksperiencë në lidhje me çështje të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë organizative si dhe përfshirjen e sektorit në advokim dhe dialogun me institucioneve për më shumë pjesëmarrje në politikëbërje.

Gjatë ceremonisë akademistët e diplomuar në fjalët e tyre vlerësuan shumë pozitivisht pjesëmarrjen në këtë program duke u ndalur veçanërisht tek profesionalizimi dhe eksperiencat e lektorëve dhe mentorëve të përfshirë, mundësitë e ofruara nga aktivitetet e programit për rrjetëzimit dhe shkëmbim eksperiencash midis pjesëmarrësve jo vetëm për çështje të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë organizative por dhe për njohjen më tej të zhvillimeve brenda sektorit, etj.

Aplikimet për Akademinë e OJF-ve 2023 hapen së shpejti në Janar! Ftojme të gjithë të interesuarit për t'u bërë pjesë e Akademisë, të na shkruajnë në info@resourcecentre.al




Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Advokim dhe Dialog për Politikëbërje

Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri



Në vijim të krijimit të grupit të përbashkët të punës me përfaqësues nga institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile pjesë e [Grupimit për Zhvillimin e Vullnetarizmit](#) në Shqipëri, në disa takime të organizatave nën lehtësimin e Qendrës Burimore dhe Përtej Barrierave është diskutuar mbi ndryshimet e propozuara në ligj nga qeveria për përmirësimin e ligjit.

Nisur nga problematika që ligji mbart, organizatat vlerësojnë si të pamjaftueshme këto ndryshime dhe janë duke punuar për komente dhe sugjerime të cilat do paraqiten së shpejti në mbledhjen e radhës së grupit të punës me përfaqësues të Ministrive dhe AKPA .

Aktivite nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri




Zyra Rajonale e NRC Vlorë ka shërbyer si ndërlidhese midis OJF në qytet që punojnë me të rinjtë me qëllim rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit midis tyre për t'ju shërbyer sa më mirë të rinjve të Bashkisë Vlorë.



Nga takimet mes organizatave të shoqërisë civile dhe gazetarëve në qytetin e Vlorës, për të diskutuar mbi problematika lokale dhe ndërtuar ura bashkëpunimi me median. - **Zyra Rajonale Vlorë**




Gjatë takimeve me Rrjetin e Dialogut Social për të diskutuar mbi çështje prioritare të grave dhe vajzave në nevojë për tu adresuar në buxhetin e vitit 2023. - **Zyra Rajonale Vlorë**



Gjatë zhvillimit të seancave mentoruese me OJF në Shkodër për rritjen e standardeve organizative, në kuadër të anëtarësimit në Kodin e Standardeve. - **Zyra Rajonale Shkodër**



Takime me studentë të këshillit studentor të Fakultetit Ekonomik dhe Shkencave Sociale për nxitjen e angazhimit vullnetar në organizata të shoqërisë civile. - **Zyra Rajonale Shkodër**



Gjatë asistencave teknike ofruar organizatave lokale Hapat e Lehte, Wellpoint dhe Dimension Human për aplikimin në platformën SMILE.AL . - **Zyra Rajonale Shkodër**


Ritja e Transparencës dhe përgjegjshmërisë së OShC-ve

Forumi i OJF-ve “Përgjegjshmëria e OJF-ve në Bashkëpunimin për Zhvillim Efektiv”

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri në datën 07 tetor 2022 organizuan Forumin e OJF-ve “Përgjegjshmëria e OJF-ve në Bashkëpunimin për Zhvillim Efektiv”.

Forumi i OJF-ve organizohet në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Përgjegjshmërisë 2022, një javë fushate gjatë të cilës OJF-të dhe platformat e tyre ndajnë eksperiencat, praktikatat e mira dhe rastet e suksesit mbi mënyrat se si OJF-të janë duke rritur përgjegjshmërinë, legjitimitetin dhe transparencën ndaj përfituesve të tyre dhe shoqërisë.

Kodi i Standardeve për OJF-të në Shqipëri, prezantuar nga Partnerët Shqipëri, ishte një ndër praktikatat e mira që u nda në këtë Forum. Puna e vetë sektorit dhe nisma të tilla që nxisin përgjegjshmërinë, transparencën dhe rrisin efektivitetin e OJF-ve, u vlerësuan si modele shumë pozitive nga gjithë pjesëmarrësit në Forum.




Fuqizim kapacitetesh Akademia e OJF-ve

Cikli i leksioneve në Programin e Akademisë së OJF-ve për vitin 2022 u mbyll me zhvillimin e tre leksioneve mbi “Advokasia dhe Lobimi”, “Qeverisja me pjesëmarrje” dhe “Komunikimi strategjik për OJF-të”.



Advokasia dhe Lobimi

#Leksioni9 u fokusua mbi përdorimin e advokasisë për të influencuar vendimmarrësit, elementët e një procesi advokimi si dhe njohjen me raste të suksesshme fushatash advokacie.



Leksioni u drejtua nga Diana Djaloshi, eksperte me një përvojë mbi 25 vjeçare në fusha të rëndësishme për sektorin jofitimprurës si hartimi dhe menaxhimi i projekteve, advokimi, zhvillimi organizativ dhe planifikimi strategjik.



Qeverisja me pjesëmarrje

#Leksioni10 u fokusua mbi kuptimin e qeverisjes me pjesëmarrje dhe dimensionet e saj, mekanizmat për përfshirjen e OShC-ve në politikëbërje dhe vendimmarrje, sfida të hasura, praktika të mirë në Shqipëri si dhe hartimi i një strategjie për angazhimin e organizatave në proceset me pjesëmarrje.

Leksioni u drejtua nga Blerjana Bino, studiuese në shkencat sociale me fokus të veçantë në media, demokraci dhe pjesëmarrje. Pjesë e kërkuesve të Rrjetit të Gazetarëve të Sigurtë në Ballkanin Perëndimor, Blerjana ka një përvojë dhe kontribut të spikatur në vlerësimin e situatave të medias në Ballkanin Perëndimor (me fokus specifik Shqipërinë). Si bashkëthemeluese dhe Drejtore Ekzekutive e Qendrës Shkencë dhe Inovacioni për Zhvillim, prej vitesh punon ngushtësisht me institucionet akademike, shoqërinë civile, institucionet publike dhe mediat duke drejtuar një rrjet studiuesish të shquar dhe kërkuesish që punojnë në zhvillimin demokratik, qeverisjen e mirë, media e komunikim dhe transformim dixhital.



Komunikimi strategjik për OJF-të

#Leksioni11 u fokusua mbi komunikimin me median dhe publikun. Përcjellja e mesazheve efektive si një mjet për rritjen e mbështetjes, komunikimi përmes medias tradicionale dhe sociale, teknika storytelling, etj. ishin disa nga çështjet e trajtuara gjatë leksionit.




Leksioni u drejtua nga Matilda Duro, e cila ka punuar në media dhe fushën e komunikimit prej mbi 17 vitesh si gazetare për çështjet social-ekonomike dhe si konsulente për Komunikimin dhe Marrëdhëniet me Publikun. Matilda është e angazhuar si lektore me kohë të pjesshme në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës për lëndën “Komunikimi në Biznes”. Gjithashtu ajo është trajnere dhe bashkëautore e modulit të medias pranë Shkollës së Administratës Publike.

Akademia e OJF-ve 2022 Sesione Mentorimi



Akademia e OJF-ve 2022 Sesione Mentorimi



Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë

Përgjatë një viti, përmes leksioneve dhe seanceve të mentorimit, akademistët kanë rritur njohuritë e tyre dhe kanë zhvilluar ose përmirësuar politika e procedura të qeverisjes organizative, manaxhimit të burimeve njerëzore, manaxhimit financiar dhe raportimit, ngritjes së fondeve, si dhe kanë punuar për hartimin dhe konsolidimin e një serie dokumentash si plane strategjike, projekt propozime, strategji dhe plane komunikimi, plane fushatash advokimi etj.

Fuqizim kapacitetesh

Vizita Studimore

Ky vit i Akademisë na sjell në takime dhe vizita prezantuese në institucione të rëndësishme dhe kompani private. Pjesëmarrësit e Akademisë si pjesë e vizitave u njohën më nga afër dhe patën mundësinë të diskutojnë më gjerësisht me përfaqësues nga:



Kuvendi i Shqipërisë për të diskutuar mbi strukturat, procedurat për përfshirjen e OJF-ve në proceset konsultuese, si dhe marrëdhënien dhe qasjen me sektorin për bashkëpunime.



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile – AMSHC për të diskutuar mbi mekanizmat e përfshirjes së sektorit në politikëbërje dhe vendimmarrje.



Bashkia Tiranë, përfshirja e OSHC-ve në vendimmarrjen lokale, partneriteti me bashkinë si ofrues shërbimesh si dhe eksplorimi i burimeve alternative të financimit për OSHC-të.


Shkrimi i Projekt Propozimit

Nisur nga kërkesat dhe interesi për këtë çështje, gjatë muajit nëntor u zhvillua një program trajnimi mbi Shkrimin e Projekt Propozimit me përfaqësues të OSHC-ve nga Lezha, Divjaka, Shkoder, Fieri, Vlora dhe Tirana. Pjesëmarrësit rritën njohuritë dhe morën informacione praktike mbi Menaxhimin e ciklit të projektit, fazat e shkrimit të një propozimi, kornizën logjike si dhe formatin e aplikimit për thirrjet e BE-së.



**Marketingu dhe Promovimi i fushatave
Crowdfunding**

Strategjia e marketingut, hapat e një fushate të suksesshme dhe përgatitja e videove dhe materialeve promovuese ishin disa nga çështjet kryesore që u trajtuan gjatë programit të trajnimit me OSHC nga Tirana dhe Elbasani. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit zhvilluan ushtrime praktike mbi organizimin e një fushate të suksesshme si dhe përgatitjen e videove dhe materialeve promovuese.



“Vullnetarizmi dhe pjesëmarrja e OSHC-ve në Programet e BE ”

Pas zhvillimit të programeve rajonale për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve mbi programet e BE-së mbi vullnetarizmin, përgjatë muajve nëntor-dhjetor, Qendra ka ofruar një seri seancash mentorimi dhe asistencë teknike për një grup OSHC të interesuara për t'u bërë pjesë e këtyre programeve në nivel Evropian dhe për t'u akredituar (Quality Label). Hapat e nevojshme që duhen ndjekur si pjesë e procesit si dhe këshilla teknike në hartimin e kërkesës për akreditim janë disa nga aspektet e trajtuara përgjatë programit të mentorimit.

Programi “Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet”

Programi ka vijuar me seancat e mentorimit dhe asistencës individuale, duke u fokusuar në hartimin dhe zhvillimin e Planeve të Biznesit si dhe Strategjive të Marketimit të shërbimeve dhe produkteve të ngritura nga OSHC-ë përgjatë programit. Njëkohësisht, duke synuar krijimin e urave të bashkëpunimit dhe partneritetit mes organizatave pjesë e programit dhe disa kompanive të biznesit, në mbyllje të programit u organizuar edhe një event OSHC-Biznes. Në një seri takimesh, direkte dhe ballë për ballë (speed dating), organizatat pjesë e programit patën mundësi të prezantojnë idetë e tyre të biznesit tek kompanitë pjesëmarrëse dhe të diskutojnë për mundësi mbështetjeje dhe bashkëpunimi të mëtejshëm.



EU aquis, angazhimi dhe roli i OSHC-ve në procesin e integritit të vendit në BE

EU aqis, angazhimi dhe roli i OSHC-ve në procesin e integritit të vendit në BE është një tjetër program i ri dizenuar nga Qendra Kombëtare Burimore, dedikuar rritjes së kapaciteteve të organizatave. Workshopi i organizuar në Tiranë, është i pari i një serie workshopesh që do të organizohen në të gjithë vendin nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.

Synimi i workshopëve është informimi i OSHC-ve mbi procesin e negociatave, strukturat negociuese dhe mundësitë për përfshirje të OSHC-ve në procesin e negociatave. Workshopi i zhvilluar në Tiranë më 14 tetor, solli sëbashku 18 organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës.

Sesioni i parë workshop-it u drejtua nga Gledis Gjipali, EMA, i cili ndër të tjera foli për raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë publikuar së fundmi duke u fokusuar në zhvillimet e procesit të përgatitjes dhe progresit të kapujve përgjatë vitit të analizuar në raport. Duke sjellë shembuj edhe nga shtetet e tjera Gjipali analizozi praktikatat e mira dhe mësimet që mund të ndihmojnë dhe lehtësojnë procesin e negociatave për Shqipërinë. [Lexo më shumë](#)



Komisioni Evropian ka publikuar Paketën e Zgjerimit 2022



Në Tetor Komisioni Evropian publikoi Paketën e Zgjerimit 2022. Raporti për Shqipërinë, në lidhje me shoqërinë civile, thekson se zbatimi i ligjit të ri për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse të miratuar në qershor 2021 nuk ka filluar ende. Këshilli i Lartë Gjyqësor mori një ndarje buxhetore për të prokuruar regjistrin elektronik të Organizatave Jofitimprurëse dhe në maj 2022 nnskhroi një kontratë për fillimin e punës në këtë drejtim.

Raporti thekson që nuk ka pasur progres në zbatimin e udhërrëfyesit për një mjedis mundësues për shoqërinë civile. Bashkëpunimi i institucionalizuar ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë duhet ende të forcohet për të siguruar pjesëmarrje domethënëse të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në proceset vendimmarrëse, duke përfshirë edhe në kontekstin e negociatave të anëtarësimit në BE. Progres, ndonëse i kufizuar, është bërë në fushën e rimbursimit të TVSH-së. Në 18 tetor, Ambasadorja e BE-së në Shqipëri Christiane Hohmann, prezantoi gjetjet e raportit të Komisionit të BE-së për Shqipërinë 2022, me një grup organizatash të shoqërisë civile.

[Lexoni këtu gjetjet kryesore për Shqipërinë](#)

[Raporti i plotë](#)

Mbledhja e Keshillit Kombëtar për Shoqërine Civile – KKShC

Në datën 1 nëntor 2022 pranë mjedisëve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u zhvillua takimi me anëtarët e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe përfaqësues të AMSHC: Z. Vladimir Thano, Znj. Fabiola Laço, Znj. Ermelinda Mahmutaj, Z. Andi Rabija, Z. Indrit Seferi, Z. Altin Hazizaj, Znj. Mirela Juka, Z. Andi Kananaj dhe Z. Erion Banushi. Lajmi është ndarë në mediat sociale dhe nuk ka shumë informacion mbi diskutimet gjatë takimit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, është shprehur se agjenda e punës vjetore të KKShC do të fokusohet në bashkëpunimin ndërinstitucional vendor si dhe qendror për të adresuar çështjet e integritimit Evropian në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Po përmes mediave sociale, është njoftuar që më datë 18 nëntor 2022, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, së bashku me Ministren e Shtetit për Standardet e Shërbimeve, Milva Ekonomi, zhvilluan mbledhjen e rradhës me KKShC, për të forcuar dialogun konstruktiv të qeverisë me shoqërinë civile, si një faktor i rëndësishëm në procesin e negociatave për integrimin në Bashkimin Evropian.



Konferenca Kombëtare e Vullnetarizmit 2.0 - “Infrastruktura e Vullnetarizmit në Shqipëri, Sinergjite dhe Sfidat”

Në ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, u mbajt Konferenca Kombëtare e Vullnetarizmit 2.0 - “Infrastruktura e Vullnetarizmit në Shqipëri, Sinergjite dhe Sfidat”, organizuar nga organizata Pertej Barrierave. Konferenca solli së bashku aktorë të rëndësishëm të institucioneve shtetërore në nivel kombëtar dhe vendor, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, vullnetarë, dhe aktorë të tjerë për të diskutuar mbi infrastrukturën e vullnetarizmit në Shqipëri dhe bashkëpunimin ndërsektorial.

Si pjesë e Panelit në Konferencë, Zj. Ariola Agolli, Menaxhere e Qendrës Burimore, diskutoi mbi vullnetarizmin në perspektivën e OSHC-ve: mjedisi (jo) mundësues, infrastruktura, kapacitetit, sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e vullnetarizmit në vend. Gjatë konferencës, u prezantua aplikacioni Mobile Volunteering, si risia më e re dixhitale në fushën e vullnetarizmit në Shqipëri. Në bashkëpunim me Beyond Barriers - Pertej Barrierave dhe organizata të tjera pjesë e iniciativës për zhvillimin e vullnetarizmit në Shqipëri, Qendra vazhdon të mbetet e angazhuar për avancimin e dialogut në sektor dhe me institucionet për një mjedis më mundësues për Vullnetarizmin në Shqipëri. [Për më shumë rreth Konferencës](#)




Java e Integritetit në Shqipëri

Përgjatë 1-10 dhjetor 2022, në Shqipëri u organizua për të katërtin vit radhazi, Java e Integritetit, një nismë e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC).

Nën logon [#weekofintegrityAL](#) gjatë Javës u zhvilluan një seri aktivitetesh nga organizata të shoqërisë civile, biznesi, institucionet akademike, etj. duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e sjelljes etike, transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe çdo përpjekjeje tjetër në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

Java u çel nga Konferenca me temë "Promovimi i Integritetit: Individit, Organizatave dhe Përtej", ku si pjesë e paneleve, drejtues të organizatave dhe aktivistë, sollën perspektivat e liderëve të rinj, vështirësitë dhe arritjet e punës së tyre të përditshme, për më shumë integritet dhe mundësi të barabarta për të rinjtë. [Për më shumë](#)



Java e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri #JavaOKB2022

Gjatë muajit tetor, Shqipëria mirëpriti Javën e Kombeve të Bashkuara #JavaOKB2022. Java u cel me ekspozitën #WeThePeoplesExpo. Aktivitetet e Javës së OKB-së në Shqipëri udhëtuan në Pukë, Përmet dhe Durrës, së bashku me koncertin "Ritmi që na Bashkon". Këto aktivitete mundësuan për qytetarët më shumë informacione rreth programeve që agjencitë e OKB-së zhvillojnë në të gjithë Shqipërinë, të njihen më thellësisht me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe të shijojnë ekspozitën dhe të argëtohen.

Java e Kombeve të Bashkuara, vjen në kuadër të javëve kulturore ndërkombëtare, të cilat po zhvillohen prej disa muajsh dhe kanë gjallëruar jetën artistiko-kulturore, jo vetëm në kryeqytet, por edhe qytete të tjera të vendit.



Dita Kombëtare e Aktivizimit #NAD2022

Përgjatë 21 dhe 22 tetor, u organizua për të pestin vit radhazi Dita Kombëtare e Aktivizimit #NAD2022. Organizata të shoqërisë civile, grupe dhe aktivistë që veprojnë në të gjithë vendin u bënë pjesë e aktiviteteve të organizuara me këtë rast. Angazhimet dhe reagimet e tyre ndër vite, si një shembull i mirë qytetarie u pasqyruan në një dokumentar të shkurtër në eventin e mbajtur pranë Qendrës Kulturore të Kompleksit të Katedrales Orthodhokse në Tiranë.

Veprimtari të shumta u organizuan anembanë Shqipërisë, duke kulmuar në shkollën 9-vjeçare “Ferraj”, në Tiranë. [Lexo më shumë këtu](#)



LevizAlbania - Prezantimi i Platformës së Njohurive për Angazhimin Qytetar



Në datën 05 dhjetor, LevizAlbania organizoi një takim për prezantimin e platformës së njohurive për angazhimin qytetar.

Gjatë takimit, u diskutua mbi përfitimet që aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile dhe bota akademike do të kenë nga përdorimi i Platformës, mundësia për të marrë informacion të detajuar jo vetëm mbi atë çfarë LevizAlbania ka bërë gjatë viteve të zbatimit por edhe dokumente dhe materiale teknike të hartuar nga ekspertë të ndryshëm në lidhje me qeverisjen vendore dhe nismat e adresuara nga bashkëpunëtorët e LevizAlbania.

Prej vitit 2015, LevizAlbania është e përkushtuar në forcimin e demokracisë vendore përmes aksioneve dhe ideve të gjeneruara nga aktorët e shoqërisë civile, individët dhe grupimet informale, duke forcuar jo vetëm demokracinë vendore por edhe rolin aktiv të qytetarëve në kërkim të një qeverisjeje vendore cilësore, transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse.

[Njihuni me Platforma online këtu](#)

Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2021

Në dhjetor u publikua Indeksi i USAID për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve në Shqipëri për vitin 2021. Sipas gjetjeve, qëndrueshmëria e përgjithshme e OSHC-ve nuk ndryshoi, pati përkeqësime të lehta në dimensionet e mjedisit ligjor, advokimit dhe imazhit publik gjatë vitit 2021.

Mjedisit ligjor pësoi përkeqësim për shkak të disa ndryshimeve në kuadrin ligjor që prek OSHC-të. Kufizimet e zgjatura në tubime, transparenca e kufizuar dhe mungesa e mundësive për t'u konsultuar me qeverinë, penguan nismat e advokimit të OSHC-ve, ndërkohë që imazhi publik i sektorit u përkeqësua pak si rezultat i sulmeve të vazhdueshme ndaj organizatave dhe aktivistëve. Dimensionet e tjera të qëndrueshmërisë së OSHC-ve mbetën kryesisht të pandryshuara.

Raporti i përgatitur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësi, njeh kontributin e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile si një infrastrukturë e rëndësishme në ndihmë të zhvillimit të sektorit të OSHC-ve. [Lexoni më shumë](#)




Forumi i shoqërisë civile & Think Tank 2022

Në datat 1-2 nëntor 2022, Instituti Aspen Gjermani në bashkëpunim me Shoqatën e Evropës Juglindore organizuan Forumin e Shoqërisë Civile dhe Think Tank në Berlin. Forumi mbledhi së bashku më shumë se 100 përfaqësues të ndryshëm si grupe studimore, shoqëri civile dhe ekspertë në fushat përkatëse për të ofruar rekomandime mbi procesin e integritimit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë dy ditëve diskutimi në panele e grupe pune, përfaqësuesit e shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor evidentuan një sërë problemesh me të cilat përballet rajoni. Ekspertët dhe aktivistët e shoqërisë civile, shkëmbyen praktikatat më të mira dhe zhvilluan rekomandime konkrete mbi tema si Agjenda e Gjelbër, "Tranzicioni i Energjisë", "Ndryshimet Klimatike" dhe "Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm Mjedisor", si dhe "Integrimi në BE në një Mjedisit Gjeopolitik në Ndryshim" dhe "Investimet në Infrastrukturë". [Lexo më shumë mbi Rekomandimet e Politikave nga Forumi](#)



Analiza vjetore nga BCSDN: Shoqëria Civile në Ballkanin Perëndimor në realitetin e ri gjeopolitik



Për të 13-tën herë radhazi, Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile ka përgatitur një analizë të Paketës vjetore të Zgjerimit të Komisionit Evropian 2022, duke vlerësuar progresin e bërë në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile dhe dialogut me institucionet publike në vendet e Zgjerimit përkundrejt gjetjeve të raportit të Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. [Lexo analizën e plotë këtu](#)

Funded by the European Union

OPEN SOCIETY FOUNDATION FOR ALBANIA

Inclusive EduJobs

Call for proposals for Sub-Grants

Sub-grants for Self-Employment Business Incubator, Farmers Support and Blended Education for Roma and Egyptians

TIRANA MUNICIPALITY

02 DECEMBER 2022 | 17:00 DEADLINE FOR APPLICATION

www.osfa.al

mbyllur

EUROPEAN CROSS-BORDER GRANTS

Stories don't stop at the border

hapur



THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

MBËSHETJE PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE NË FUQIZIMIN ORGANIZATIV DHE PËRMIRËSIMIN E TRANSPRENCËS E LLOGARIDHËNIES



mbyllur

INA INVESTIGATIVE NETWORK ALBANIA

THIRRJE PËR PROPOZIME RRJETE TELEVIZIVE

PARTNERITETI MES QENDRËS SHQIPTARE PËR GAZETARI CILËSORE, INSTITUTIT SHQIPTAR TË MEDIAS DHE QENDRËS FOL, NË ZBATIM TË PROGRAMIT INVESTIGATIVE NETWORK ALBANIA, HAP THIRRJEN PËR PROPOZIME NGA ORGANIZATA MEDIATIKE TË SHOQËRISË CIVILE

DETAJET MBI THIRRJEN I GJENI NË WWW.INA.MEDIA

Albanian Media Institute Institut Shqiptar i Medias

ALBANIAN CENTER FOR QUALITY JOURNALISM

SERBIA FOL

mbyllur

THIRRJE DHE MUNDËSI

Shërbim Ligjor për OJF-të

info@resourcecentre.al

hapur

OPEN CALL FOR APPLICATIONS

INFO SESSION

ИНФОРМАТБНА СЕСИЈА

INFO SESIJA

BILGËNDIRME TOPLANTISI

SESION INFORMUES

READ Open Call for Support of INTERCULTURAL projects in North Macedonia, Albania, Kosovo, Serbia and Turkey.

hapur

7TH CALL FOR

CLIMATE ACTION PROJECT IDEAS

APPLY BY 13 JANUARY 2023

hapur

EUROPEAN YOUTH PORTAL

hapur


KALENDAR TREMUJOR

Shënoni në kalendarin tuaj! Përfshihu në aktivitetet tona të ardhshme!

Janar 2023						
S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

Shkurt 2023						
S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28				

Mars 2023						
S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	30	30	31	



Akademia e OJF-ve



Trajime dhe Seminare për OShC-të



Aktivitete rrjetëzimi



Forume Publike dhe Evente

NA KONTAKTONI :

Zyra në Tiranë

Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i 10të,
Ap. 73, Tiranë

(në mjediset e "Partnerët Shqipëri për
Ndryshim dhe Zhvillim")

Tel/Fax: +355 4 2254881

E-mail: info@resourcecentre.al

Zyra në Shkodër

Lagjja Kongresi i Përmetit, Rr. Oso Kuka,
Kati i 2të, Hyrja 1, Shkoder

(në mjediset e Shoqatës "Gruaja në
Zhvillim")

E-mail: shkodra@resourcecenter.al

Zyra në Vlorë

Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede Ahmet Amataj,
Çerdhja 15, Kati i 2të, Vlorë

(në mjediset e Qendrës "Aulona")

Tel: +355 3 3224531

NA NDIQNI :  [resourcecentre.al](https://www.facebook.com/resourcecentre.al)

 [resourcecentrealbania](https://www.instagram.com/resourcecentrealbania)

 [resourceCSO_al](https://twitter.com/resourceCSO_al)

 [ResourceCentreAlbania](https://www.youtube.com/ResourceCentreAlbania)

 <http://www.resourcecentre.al/>

 [National Resource Centre for Civil Society in Albania](https://www.linkedin.com/company/national-resource-centre-for-civil-society-in-albania)